



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 94-të të mbajtur më 13.10.2023, ka miratuar sa vijon.

## VENDIM

Denoncimi me numër 12-1023/1 nga 13.02.2023 me pretendime për veprime dhe ngjarje në territorin e Komunës -----, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-1023/1 nga 13.02.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 13.02.2023 është dorëzuar denoncim me pretendime për veprime dhe ngjarje në territorin e Komunës ----- dhe u formua lënda me numër 12-1023/1 nga 13.02.2023.

Denoncimi përmban pretendime, siç deklaroi parashtruesi, për një mafie urbane në Komunën e ----- . Thuhet se noteri ----- po ndërtonte një ndërtesë të lartë pranë gjykatës ku ndodhen të gjitha organet e drejtësisë dhe po mbyllet drita në të gjithë ndërtesën Thuhet se në të njëjtën mënyrë kanë vepruar së bashku me kryetarin e Komunës gjatë rinovimit të një dyqani të vjetër, miratimi i të cilit ishte i paligjshëm. Parashtruesi kërkon nga KSHPK-ja, nëse ka plan urbanistik, ta kundërshtojë atë sepse pretendohet se është miratuar ilegalisht.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se denoncimi nuk përmban pretendime të qarta për mënyrën se si është kryer keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga një zyrtar dhe gjithashtu kërkon veprim që është jashtë kompetencës së KSHPK-së në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Nga aty, KSHPK-ja konsideroi se nuk ka kompetencë të veprjë në rastin në fjalë, prandaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar: parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B:K:SH  
Miratoi: V:G., Anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska

